



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice  
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Corectional Service  
Drejtoria e Përgjithshme Prishtinë

Datë:13.02.2025

Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe paragrafit 6, si dhe duke u bazuar në paragrafin 2 nën paragrafi 2.3 dhe paragrafit 3 dhe 4 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me datë 13.02.2025 publikon këtë:

**SHPALLJE PUBLIKE**

*Për pranimin e aplikimeve për një (1) ekspert të jashtëm për anëtar të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese*

**1. Kandidatët për ekspert të jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, në pajtim me dispozitat e nën paragrafit 2.3 paragrafit 2 të nenit 23 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:**

- Të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
- Të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një Vepre penale jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

**2. Për Kandidatët për ekspert të jashtëm të Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:**

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidatët për ekspert i jashtëm për kategorinë e lartë drejtuese si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimi për kategorinë e lartë drejtuese, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimi në Shërbimin Civil.

**Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikët 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike për anëtar të Komisionit të Pranimi për kategorinë e lartë drejtuese, është i hapur nga data: 18.02.2025 deri më datë: 28.02.2025 deri në ora 16:00.**

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim për *ekspert i jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimi për kategorinë e lartë drejtuese* dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: <https://shkk.rks-gov.net>

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: **038 200 67585** ose në emal adresën e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; <https://shkk.rks-gov.net>

Ju faleminderit!